

VENDIM
Nr.57, datë 3.8.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË TEC-VLORA
SH.A. PËR TARIFËN E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TE FURNIZUESI PUBLIK
ME SHUMICË (FPSH)**

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 3 dhe 20 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.8.2009, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të TEC-Vlora sh.a. për tarifën e shitjes së energjisë elektrike te furnizuesi publik me shumicë (FPSH),

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të TEC-Vlora sh.a. për tarifën e shitjes së energjisë elektrike te furnizuesi publik me shumicë (FPSH).
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta